

29.01.2022  
Ora 12:10

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike, subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• Komisioni Rregullator:

- |            |       |                       |
|------------|-------|-----------------------|
| • Ilirjana | NANO  | Kryetar               |
| • Arens    | ÇELA  | Anëtar                |
| • Dritan   | ÇAKA  | Anëtar                |
| • Helga    | VUKAJ | Anëtar                |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar                |
| • Stafi    | KQZ   | M. Koja, V. Ballgjini |

Parti Politike: LSI (A. Kaziaj)

OJQ: KRIK

*Znj. I. Nano:* Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, e shtunë 29 janar 2022. Njoftimi është bërë në faqen publike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu rendi i ditës, të cilin do ta prezantoj pas pak, u është njoftuar si anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe përfaqësuesve të partive politike. Në këtë mbledhje në rendin e ditës janë parashikuar shqyrtimi dhe miratimi i dy projektvendimeve. I pari, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike, subjekteve

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.29.01.2022*

zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Projektvendimi i dytë, “Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Të pranishëm në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësues të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të partive politike. Paraprakisht më lejoni t’ju pyes kolegë, si dhe përfaqësuesit e partive politike nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar? Nëse jo, fillojmë me rendin e ditës. Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike, subjekteve zgjedhore. Kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kush do ta prezantojë projektaktin? Zonja Koja, po faleminderit!

**Znj. M. Koja:** Përshëndetje! Atëherë, në përputhje me rendin e ditës që Komisioneri i ka propozuar Komisionit Rregullator, i pari në radhë për shqyrtim është projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar, të partive politike, subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organet e vetëqeverisjes vendore”. Objekti i projektvendimit që propozohet është përcaktimi i rregullave të veçanta për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike kur konkurrojnë më vete, apo si pjesë e një koalicioni. Përfshirë këtu raportimi i kandidatëve për kryetar bashkie, i kandidatëve të listave shumemërore për këshilltarë bashkiakë dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Krahas përcaktimit të rregullave, për mënyrën sesi plotësohet formulari, projektvendimi bënte miratimin e formateve standarde, të raportimit, për subjektet e sipërcituara. Gjithashtu

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



miratohet në këtë rast, propozohet të miratohet në këtë rast dhe modeli i raportimit të raportit të auditimit nga ana e ekspertëve kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të kontrolluar raportet financiare për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Projektvendimi si risi ka specifikimin e hartimit të raporteve të dedikuara posaçërisht për rastin e zgjedhjeve vendore. Tashmë, Komisioni Rregullator ka miratuar një projektvendim të ngjashëm për zgjedhjet për Kuvend, sot propozohet miratimi i këtij projektvendimi, për zgjedhjet për pushtetin vendor, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Koja! Sikundër dhe ju e theksuat ne kemi miratuar më herët një projektvendim, i cili lidhet me rregullat për raportimin financiar të partive politike, apo dhe subjekteve të tjera zgjedhore, gjithashtu dhe kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, për zgjedhjet për Kuvend. Do të doja të theksoja që ky projektvendim që po shqyrtojmë sot, nuk lidhet vetëm me zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, në gjashtë bashki të vendit, sipas dekretit të Presidentit të Republikës, por është një projektvendim që do të zbatohet edhe për zgjedhjet vendore të rregullta të përgjithshme. Pra, jo vetëm në zgjedhjet e pjesshme vendore. Atëherë çelim diskutimin në parim për projektvendimin, kolegë? Zoti Kaziaj, si përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

---

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në parim nuk kam asgjë, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Kaziaj! Atëherë nëse kolegët nuk kanë diçka për të diskutuar në parim për projektin, atëherë do të kalojmë në votimin e projektvendimit në parim.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë me diskutimin nen për nen.

Neni i parë. Objekti. Ky vendim ka si objekt:

- a. përcaktimin e rregullave të veçanta për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike kur konkurrojnë më vete, apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit;
- b. miratimin e modeleve të raportimit për partitë politike kur konkurrojnë më vete, apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.
- c. miratimin e modelit të raportit të auditimit nga audituesit ligjorë, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të kontrolluar raportet financiare për fushatën zgjedhore të subjekteve të përcaktuara në shkronjën "a", të këtij neni;
- d. afatet për publikimin e raporteve;
- e. përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësive të financierëve të subjekteve, përcaktuar në shkronjën "a" të këtij neni.

Fillojmë diskutimin për këtë nen. Paraprakisht unë do doja të sqaroja edhe audiencën, por edhe partitë politike që janë të interesuara në këtë proces. Kur flasim për financierë të subjekteve të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, kemi parasysh subjekte: parti politike, koalicione zgjedhore, kandidatë të propozuar nga partitë politike dhe subjekte zgjedhore, që mund të jenë kandidatë për kryetar bashkie, apo për listat shumemërore, pra për anëtarë këshillash, por kemi gjithashtu dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Në këtë rast, ajo ç'ka duhet theksuar është fakti që edhe kandidatët e propozuar nga

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



zgjedhësit, siç do të rezultojë dhe më tej në projektvendim, duhet të kenë një financiar të tyre. Ndërsa kandidatët që janë të propozuar nga partitë politike, e realizojnë këtë detyrim nëpërmjet financiarit të partisë. Ndonjë diskutim lidhur me nenin 1? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 1. Kush është dakord me nenin 1, sipas përmbajtjes së propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve?

***Kolegë, kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Raportet e monitorimit. Monitoruesit e zgjedhjeve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për monitorimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të përcaktuara në shkronjë "a", të nenit 1, të këtij vendimi, me detyrimet sipas Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dorëzojnë në KQZ:

- a. raportin e ndërmjetëm çdo 10 ditë nga fillimi i periudhës së monitorimit deri në ditën e zgjedhjeve;
- b. raportin mbi shkeljen e vërejtur gjatë monitorimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të incidenteve, në të njëjtën ditë që bëhet vëzhgimi;
- c. Raportin përfundimtar të monitorimit, jo më vonë se 7 ditë pas ditës së zgjedhjeve.

Pika 2. Raportet e ndërmjetme të incidenteve dhe raporti përfundimtar i monitorimit, publikohen në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda 2 ditëve pune nga depozitimi i tyre në KQZ. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve publikon gjithashtu çdo masë apo vendim që ka marrë në lidhje me këto raporte.

Besoj që është i njëjti standard që kemi miratuar dhe më herët për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Kolegë, zoti Kaziaj, lidhur me nenin 2, nëse ka diçka?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk kisha asnjë gjë e nderuar zonja kryetare, vetëm doja të bëja një ndërhyrje të përgjithshme përsa i përket pjesës së vendimmarrjes që ky komision do ndërmarrë me këtë akt. Siç u tha dhe më parë, është një akt i ngjashëm i ndërmarrë nga ana juaj në vitin 2021, që mban numrin 13. Do të doja vetëm për efekt kohe, në qoftë se është e mundur nga ana juaj, mos t'i futemi nen për nen leximit, por siç kemi kaluar në seancat e tjera, të themi me nene përkatëse dhe atje ku ka ndërhyrje për shtesa ose ndryshime nga ana e palëve, të mund ta bëjmë me mirëkuptim këtë gjë.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Kaziaj! Në fakt është një akt voluminoz, duke llogaritur vetëm tekstin e projektvendimit, por njëkohësisht dhe 8 shtojca të tij. Kështu që nëse dhe kolegët janë dakord me propozimin e zotit Kaziaj?! Unë nuk po i lexoj të gjitha nenet me radhë, por gjatë diskutimit nen për nen, nëse kemi diçka konkrete, një propozim për shtesë apo ndryshim në një nen konkret, do ta bëjmë në kohën e duhur. Atëherë, jemi në momentin që duhet të votojmë nenin 2, raportet e monitorimit.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 2!

Neni 3. Raporti financiar për fushatën zgjedhore, i cili përcakton dhe pika më e rëndësishme e tij, përcakton të gjitha shtojcat e këtij vendimi, qoftë për partitë politike, për kandidatët për kyetar bashkie, për kandidatët e listave shumemërore, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, shtojca për bilancin e aseteve të partisë politike dhe për afatin e raportimit dhe publikimit të tij. Kemi diçka për nenin 3, ju lutem? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 3.

**Kush është dakord me nenin 3, me këtë përmbajtje?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 4. Kontrolli paraprak i raporteve financiare, ose kontrolli *prima facia*, përcakton modalitetet, afatet lidhur me kontrollin paraprak të raporteve financiare dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kologë kemi diçka lidhur me nenin 4, ndonjë propozim konkret? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 4.

**Kush është dakord me nenin 4, kontrolli paraprak i raporteve financiare?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 4!

Neni 5. Raporti i auditimit lidhet me atë që zonja Koja prezantoi dhe më herët, me audituesit e përzgjedhur nga KQZ-ja. Zonja Vukaj ka diçka lidhur me nenin 5, po!

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, neni 5 apriori, ka rregullshmëri, por duke qenë që auditimi tashmë është standartizuar dhe ne jemi të kondicionuar të ndjekim standardet dhe t'i aplikojmë standardet jo vetëm të brendshme të auditimit, por dhe ato ndërkombëtare, shihet e nevojshme meqenëse dhe struktura jonë e auditimit sigurisht që do auditohet pas këtij procesi. Pra, do ketë një postverifikim, shihet e nevojshme që për rregullshmëri të procesit duhet të shtohet mendoj në pikën e parë, këtë ta konsiderojë administrata, ose si një element që nuk ka nevojë për një propozim, por thjesht për identifikimin e standartit ndërkombëtar që aplikohet, në pikën e parë. Në pikën e dytë duke iu referuar, po përsëri standardeve ndërkombëtare të auditimit, kur audituesi i jashtëm i kontraktuar nga KQZ-ja, kontraktohet për këtë proces, mbart detyrimin që sipas shtojcës 6, të paraqesë mbi bazën e standardeve ndërkombëtare, 4 opinionet e tij. Ndërkohë administrata ka vendosur 2 opinionet

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



dhe diku aty në rreshta i përmend. Por, do të sugjeroja që të jetë e parashikuar konkretisht, 4 detyrimet e audituesit të jashtëm. Bazuar përsëri në standardet ndërkombëtare janë: opinionit pa rezervë, me rezervë, kundërshtues dhe refuzues. Pa këtë nuk do të ishte i plotë asnjë opinion i dhënë nga çfarëdoj audituesi. Kjo mendoj që i konsolidon edhe mbarëvajtjen e dokumentacionit nga ana jonë, por do të kemi dhe pasqyrë më të konsoliduar, faleminderit! Nuk besoj se ka nevojë për propozime.

**Znj. I. Nano:** Në rregull! Nuk do ta konsiderojmë një propozim për ta votuar, por një sugjerim për administratën që tek shtojca konkrete, qoftë tek pika e parë e vendimit, por dhe në shtojcën 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi, të reflektohen edhe dy standardet e tjera që përmendi zonja Vukaj. Kjo, për ta sjellë edhe këtë auditim, pikërisht në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit. Atëherë kolegë, këtë po e konsiderojmë të mirëqenë. Pra, gjatë zbardhjes administrata do të duhet ta reflektojë. Ndërkohë kemi ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim, ju lutem, në nenin 5? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 5!

**Kush është dakord?**


**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 6. Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore. Është një nen i gjatë. Një nen që përcakton procedurën e kontrollit të raporteve financiare. Nëse keni diçka për të pyetur administratën lidhur me këtë nen, ose nëse keni identifikuar vetë ndonjë mundësi për shtesë apo për ndryshim?! Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 6.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**





***Kush është dakord me nenin 6, “Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore”?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S’ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 6!

Neni 7. Financieri. Përcakton subjektet që duhet të caktojnë financierë. Papajtueshmëritë, kushtet në të cilat ndërpriten marrëdhëniet me financierin. Rastet e rëmërimeve të financierëve dhe marrëdhënia me KQZ-në në rastet e rëmërimeve. Unë theksoj dhe njëherë për sqarim që kur flasim për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 1, që kanë detyrimin për të patur financierë, rasti i partive po se po, por edhe rasti i kandidatëve që mund të jenë të partive, kërkon financierë gjithashtu më vete. Duhet të kenë financierë kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Zoti Çakaj!

***Z. M. Çakaj:*** Po, faleminderit zonja Nano! Unë kisha një pyetje për drejtoreshën e auditit. Duke marrë në konsideratë faktin se në zgjedhjet e përgjithshme, pra për Kuvend të datës 25 prill, kanë marrë pjesë dhe kandidatët të pavarur. A kanë raportuar, a kanë caktuar një financier kandidatët e pavarur, për të raportuar financat e tyre, në raport me standartin e vendosur në vendimin e Komisionit Rregullator nr.13?

***Znj. V. Ballgjini:*** Po zoti Çakaj, atëherë nga eksperiencia e zgjedhjeve për Kuvend, duke qenë se dhe koha ishte e pamjaftueshme që kandidatët të njiheshin me rregullat e vendosura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kandidatët e pavarur nuk kanë sjellë përfaqësues financierë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

***Z. M. Çakaj:*** Kanë raportuar individualisht vetë?

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



**Znj. V. Ballgjini:** Kanë raportuar, por jo nëpërmjet financierëve. Raportet i kanë sjellë, por jo nëpërmjet financierëve.

**Z. M. Çakaj:** Qartë, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Atëherë, nisur nga shqetësimi që parashtroi zoti Çakaj, unë do të mendoja që pas miratimit të këtij akti edhe në kuadër të trajnimeve që ju zhvilloni lidhur me financimet, do të sugjeroja një fushatë ndërgjegjësuese. Minimalisht njoftimin për detyrimin që kanë, por dhe një fushatë ndërgjegjësuese për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për të pasur parasysh këtë detyrim, lidhur me financierin dhe më tej edhe me raportimin. Duke qenë që nuk kemi propozime për shtesa dhe ndryshime, ju ftoj të votojmë nenin 7 të projektvendimit, "Financieri".

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka


Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 8. Përgjegjësitë e financierit. Në këtë nen trajtohen në mënyrë të detajuar, cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e financierit të subjekteve të përcaktuara në shkronjën "a", të nenit 1 të këtij vendimi. Duke patur parasysh si administrimin e veprimtarisë financiare deri në kontrollin e financimeve, të shpenzimeve të fushatës, dorëzimin e raportit financiar, ruajtjen e arkivit dhe një kontakt të vazhdueshëm me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për t'iu përgjigjur në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitur qoftë nga audituesi, qoftë nga KQZ-ja. Kemi diçka lidhur me nenin 8, ju lutem? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 8.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Kundra: S'ka**


Me 5 vota pro, miratohet neni 8!

Kalojmë tek neni 9. Pergjegjësitë e kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve për kryetar bashkie. Drejtoresha e auditit nëse mund të na sqarojë më tepër lidhur me këtë nen.

**Znj. V. Ballgjini:** Atëherë, siç u theksua dhe pak më lart, për detyrimet që u lindin të gjitha subjekteve zgjedhore të regjistruara, pra si subjekte zgjedhore për pjesëmarrjen në zgjedhje, të gjithë kandidatët kanë detyrimin të bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet e tyre, por me disa ndryshime të vogla. Pra, nëse do të themi, subjekti zgjedhor referuar Kodit Zgjedhor dhe përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, janë të gjithë ata kandidatë të cilët janë kandidatët e propozuar nga vetë zgjedhësit, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Këta kanë detyrimin për të pasur financierë dhe për të dorëzuar raportet e tyre financiare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet financierëve. Kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie e kanë detyrimin për të deklaruar këto pasqyra financiare, por jo drejtpërsëdrejti në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pra, të gjithë këtë veprimtari ato e kryejnë nëpërmjet financierit të partisë, e cila është e regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Afatet e përcaktuara në këtë projektvendim janë të tilla që partia politike, pra subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje kanë detyrimin të paraqesin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve pasqyrat e tyre financiare brenda 60 ditëve nga dalja e rezultatit përfundimtar. Ndërsa kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët për kryetar bashkie kanë detyrimin të paraqesin pranë financierëve të partive, të cilat i kanë propozuar...

**Znj. I. Nano:** Pra, në rastin e kandidatëve që janë të propozuar nga partitë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Znj. V. Ballgjini:** Të propozuar nga partitë. Ndaj theksova, të partive që i kanë propozuar, të paraqesin pranë financierit të partisë të gjitha pasqyrat financiare në lidhje me fushatën zgjedhore, brenda 30 ditëve nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Nga data e përfundimit të zgjedhjeve, brenda 30 ditëve, pra ata duhet të paraqesin pranë financierëve të partive, të cilat i kanë propozuar, aktivitetin e tyre financiar në lidhje me fushatën zgjedhore, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Në rregull, faleminderit! Nëse nuk ka pyetje apo sqarime të tjera, qoftë shtesa, ndryshime të propozuara, kalojmë në votimin e nenit 9.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 9!

Neni 10. Sanksionet. Bashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar. Dëshiroj ta lexoj këtë nen. "Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja, raportohen në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht në përputhje me nenin 173 të Kodit Zgjedhor". Zoti Kaziaj, kishit një pyetje?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, kisha një konstatim dhe në kuadër të asaj që ishte dhe shqetësimi i zotit Çakaj, por dhe konfirmimi i drejtoreshës së auditit në KQZ. Në këtë nen parashikohet të miratohet të themi, sanksionet, në rast mosbashkëpunimi, refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi, vonesa dhe shumë gjëra të tjera dhe konsiderohet në bazë të nenit 248 të Kodit Penal, si vepër penale, të shpërdorimit të detyrës. Kumulativisht ndëshkohet personi, ose subjekti në këtë rast edhe administrativisht. Tani në kuadër të shqetësimit të zotit Çakaj, kur kemi një evidencë, të paktën nga zgjedhjet e fundit që subjektet

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



ose kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk kanë caktuar financierë dhe nuk kanë raportuar, si do të funksionojë në këto zgjedhje? Se është e rëndësishme kjo gjë.

**Znj. I. Nano:** Në rregull! Zonja Ballgjini!

**Znj. V. Ballgjini:** Një sqarim, e thënë edhe pak më parë, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk kanë caktuar financierë, por kanë deklaruar. Kanë sjellë deklaratimet, brenda afateve të përcaktuara, pra nuk ka ndonjë refuzim për bashkëpunim dhe janë audituar. Nuk ka pasur, thjesht nuk kanë përcaktuar financierë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por veprimtarinë e tyre financiare për zgjedhjet për Kuvend e kanë raportuar në KQZ.

**Z. M. Çakaj:** Pra, me pak fjalë, në rast se një kandidat i pavarur, për të gjitha arsyet e mundshme, pra nuk ka mundësi, nuk e gjen, nuk ka besim, për të gjitha arsyet e mundshme, pa e paragjykuar, nuk cakton një financier, së pari detyrimi i tij për të raportuar shpenzimet, gjithë veprimtarinë financiare në fushatën zgjedhore e merr personalisht ai, në raport me KQZ-në dhe në këtë frymë nuk është vendosur në akt detyrimi i domosdoshëm për të caktuar financierë, përveç partive politike. Pra, prandaj dhe nuk ka sanksione.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Por kjo është deri diku, të themi dikush që merr përsipër të kandidojë për një pozicion të caktuar të parashikuar në ligj, që është deri diku diskriminues ose mëvetësues, aneksues, të themi. Pse subjekti që ngarkohet me ligj subjekti zgjedhor duhet ta ketë financieri dhe një kandidat i pavarur nuk duhet ta ketë. Sanksionohet subjekti në qoftë se nuk e ka, kandidati e merr përsipër vetë. Më duket pak diskriminuese si normë kjo gjë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë dhe njëherë do t'i bëja thirrje administratës për këtë çështje, sepse ne në rregullat tona jemi duke sanksionuar që edhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit duhet të ketë financier. Pra, është plotësuar detyrimi i tij në një masë të caktuar për raportimin. Kështu që nuk parashikohet sanksioni, ose mund të lidhet sanksioni administrativ me nenin 173. Zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Në këto kushte, një pyetje përsëri për administratën edhe në funksion të dy shqetësimeve që ngritën kolegët. A do të quhej e parregullt kjo mënyrë raportimi? Pra në këto kushte, me këtë përmbajtje, kur kandidati merr përsipër që ta sjellë vetë raportimin pa detyrimin e respektuar të sjelljes prej një financieri. Pra, a duket që vërtet mungon kjo pjesa e vënies në *ristrikt* pra, e vënies nën kushtet e presionit ligjor të këtij kandidati? Diçka tjetër në funksion të kësaj. Si e keni konsideruar raportimin deri tani nga kandidatët e pavarur me vullnetin e tyre dhe vetë ata, pa prezencën e një, ose jo nëpërmjet një financieri, e keni konsideruar të rregullt si proces deri tani?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, unë personalisht si e konceptoj aktin, parashikimi i financierit, pra në mënyrë detyruese i financierit për partitë politike, sigurisht më qëndron si logjikë, pasi ata e kanë detyrimin, kanë një aktivitet financiar më të gjerë dhe normalisht dhe gjithë aktiviteti i tyre financiar do të duhet raportuar dhe koordinuar në KQZ nëpërmjet financierit. Ndërkohë, që kandidati i pavarur në gjykimin tim në raport me mënyrën se si është gjykuar në këtë akt, në rastin konkret mund të shihet si një ndihmë përcaktimi i financierit. Pra, në këtë frymë nuk është vendosur një sanksion, por është fryma e aktit e lënë në tagrin e kandidatit të pavarur për të përcaktuar ose jo një financier, por gjithsesi detyrimi thelbësor i tij është të raportojë gjithë veprimtarinë financiare. Për këtë qëllim edhe në nenin 10 nuk është parashikuar një sanksion. Pra, qëllimi dhe fryma e aktit nuk është, cakto financierë ose..., qëllimi dhe fryma e aktit është, raporto

gjithë veprimtarinë financiare në KQZ, në mënyrë që të monitorohet nga KQZ dhe të ballafaqohen shpenzimet, të ardhurat në raport me ato çfarë ke deklaruar. Përcaktimi i financierit në rastin konkret është një ndihmë për të sjellë raporte dhe pasqyra financiare në standartin e kërkuar nga KQZ. Kështu e gjejkoj dhe kështu e vlerësoj unë paraqitjen e aktit.

**Znj. I. Nano:** Në fakt edhe unë bie dakord me kolegun Çakaj që fryma e aktit lidhet me detyrimin për raportim dhe më tej edhe me auditimin. Megjithatë KQZ-ja dhe në këtë rast nuk jemi ne, do të ishte Komisioneri, në qoftë se do të vlerësohej si shkelje e detyrimeve të këtij vendimi, mungesa e një financieri për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit mundet të paktën administrativisht të ndëshkohej. Megjithatë, në qoftë se ju kolegë nuk keni propozime konkrete për ndonjë shtesë apo ndryshim në nenin 10, unë ju ftoj ta votojmë atë.

***Kush është dakord?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 10!

Neni 11. Shfuqizim. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, dispozitat e vendimit nr. 256, datë 08.05.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, shfuqizohen".

***Kush është dakord me nenin 11, shfuqizimin e aktit të mëhershëm?***

***Pro:*** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 12. Hyrja në fuqi. Në pikën 2 të këtij neni, pika e parë është "Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve". Në pikën 2 do t'i lutesha administratës një korrigjim të vogël, e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



para Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, kemi thënë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe të saktësohet afati prej 5 ditësh nga shpallja e këtij vendimi.

***Kush është dakord, me nenin hyrja në fuqi?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Duke qenë që e miratuam aktin në parim nen për nen, po kalojmë në votimin në tërësi, edhe njëherë iu drejtohem kolegëve.

***Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?***

***Pro:*** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

***Kundra:*** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Në përfundim do t'i sugjeroja administratës së pari, për të mbajtur në vëmendje ato ç'ka kolegia Vukaj diskutoi lidhur me nenin 5, raporti i auditimit dhe shtojcën përkatëse dhe këtë korigjimin e vogël në nenin e fundit.

**Vendimi nr. 9**



29.01.2022  
Ora 12:40

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• Komisioni Rregullator:

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ M. Koja, V. Ballgjini

Parti Politike: LSI (A. Kaziaj)

OJQ: KRIK

*Znj. I. Nano:* Mirë, atëherë kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, “Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Edhe ky projektvendim ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zonja Koja do të prezantoni projektvendimin, faleminderit!

*Znj. M. Koja:* Atëherë, në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021, për herë të parë u vendos nga Komisioni Rregullator dhe u zbatua sistemi i identifikimit

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



elektronik të zgjedhësve, si një instrument i teknologjisë që garanton më mirë parimet e ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit të votimit. Nisur nga procesi i këqyrjes paszgjedhore që vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zbatoi, propozohet që dhe në zgjedhjet e pjesshme vendore të 6 Marsit të vitit 2022, të aplikohet përsëri procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe kjo është një kompetencë vendimmarrëse e Komisionit Rregullator, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Po, faleminderit zonja Koja! Çelim diskutimin në parim për projektvendimin, edhe unë do doja të shtoja diçka, ose të ritheksoja diçka. Prosesi i identifikimit elektronik të votuesve, jo vetëm ditën e zgjedhjeve, por dhe nga këqyrja paszgjedhore u vlerësua një proces i suksesshëm, kuptohet me problematika relativisht të vogla teknike. Kështu që përdorimi edhe njëherë i kësaj teknologjie, pra, i pajisjes së identifikimit elektronik PEI, që ne e kemi miratuar edhe më herët, mendoj që do të konsiderohej një hap më përpara në një standard të vendosur tashmë. Kolegë kemi diçka? Po, zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit zonja Nano! Pasi jam njohur me projektvendimin, në respekt edhe të frymës së Kodit Zgjedhor, konkretisht neni 14 i Kodit Zgjedhor “Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”. Besoj thjesht një saktësim, se në parashikimin së pari, të dekretit të Presidentit. Së dyti, të kuadrit të bazës ligjore, unë në fakt do të doja të shtoja, pra e kam propozim, në fjalët e fundit “me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve” do doja të shtoja “dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”. Në nenin 14 të Kodit Zgjedhor, pika 2 parashikohet që Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është përgjegjës për caktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik. Bashkushtron me të drejta të barabarta me Komisionerin kompetencat për zgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhjeve. Duke qenë që qëllimi i këtij akti është implementimi ose përdorimi i teknologjisë, konkretisht në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars, thjesht një propozim që krahas Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në propozimin e këtij akti të vihet dhe Nënkomisioneri, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj unë kam vetëm një merak procedural, në mënyrë që të jetë propozim edhe i Nënkomisionerit, pra duke qenë parimisht dakord me ju, do të duhet vullneti i Nënkomisionerit, i shprehur për këtë gjë. Pra, nuk është thjesht një ndryshim në një dispozitë.

**Z. M. Çakaj:** E ka shprehur vullnetin, na e konfirmoi dhe administrata.

**Znj. I. Nano:** Nuk e di, nëse ka nevojë që të kemi Nënkomisioneren këtu për ta shprehur vullnetin. Pra, duhet të jetë një vullnet i përbashkët. Pra, nuk është një ndryshim që mund ta bëjmë ne, në përmbajtjen e aktit, është çështje e propozuesit. Kështu që nëse nuk e kemi sot, do të duhet ta shtyjmë aktin për një ditë tjetër për ta vlerësuar.

**Znj. H. Vukaj:** Zonja Nano, neni 14 përcakton qartë që është detyrim i Nënkomisionerit për të bashkërenduar me të drejta të barabarta pikërisht për këtë proces, atëherë do të thotë që detyrimi nuk negociohet.

**Znj. I. Nano:** Duhej ta kishte ushtruar këtë të drejtë dhe të kishte përmbushur këtë detyrim këtë do të thuash?! Pra s'mund ta negociojmë ne, ne na ka ardhur një akt me propozim të Komisionerit.

**Znj. H. Vukaj:** Duke qenë që organi që normon, absolutisht nuk mbetet në meritën apo diskrecionin subjektiv që të pyesim nëse do ta ushtrosh apo jo?! Nëse ligji e parashikon të bashkushtrohet, do të bashkushtrohet, pavarësisht...

**Znj. I. Nano:** Nuk e ka bashkushtuar, këtë jemi duke thënë. Pra, ne na ka ardhur si propozim i Komisionerit, ndërkohë kemi pas akte në zgjedhjet e kaluara që kanë ardhur...

**Z. M. Çakaj:** Në rast se neni 14, pika 2, parashikon që këtë tagër, këtë kompetencë, Komisioneri e bashkushton me Nënkomisionerin dhe kjo ka ardhur me një, atëherë ka një problem. Ky akt nuk duhet të paraqitet në këtë formë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë 10 minuta pushim, bëjmë një saktësim! Po, zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kisha dhe unë një saktësim, këtu kemi vullnet të ligjvënësit, jo të Komisionerit. Ju vetë si Komision Rregullator në akte të tjera të propozuara dhe nga Komisioneri, keni bërë ndryshime mbi to, pavarësisht vullnetit të tij, kështu që nuk mendoj që lihet në vullnetin e Nënkomisionerit.

**Znj. I. Nano:** Zoti Kaziaj, më lejo diçka! Ndryshimi fillon që nga pjesa “vendosi, nenet, përmbajtja”, ndërsa propozuesin nuk e ndryshojmë dot ne me vullnetin tonë, sepse nuk është propozuar nga zonja Pelinku. 10 minuta pushim të saktësojmë diçka dhe rikthehemi!

**Rifillon mbledhja**

**Ora 12:53**

(Në mbledhje prezent Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve zonja Lealba Pelinku)


**Znj. I. Nano:** Atëherë rikthehemi në mbledhjen e Komisionit Rregullator. Ishim duke shqyrtuar projektvendimin “Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve në zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Pas një propozimi të zotit Çakaj, që vërejti detyrimin për një bashkëpropozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve lidhur me këtë akt, që lidhet me përdorimin e pajisjes elektronike. Zonja Pelinku është e pranishme. Ju lutem zonja Pelinku, lidhur me bashkëpropozimin!

**Znj. L. Pelinku:** Përshëndetje! Jam në dijeni të përmbajtjes së projektvendimit dhe në përputhje më nenin 14 të Kodit Zgjedhor shpreh vullnetin dhe dakordësinë time lidhur me përmbajtjen që ju është paraqitur juve nga administrata, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Zonja Koja, vullneti i Komisionerit ka qenë për ta propozuar, është për t’u bashkëpropozuar me zonjën Pelinku?

**Znj. M. Koja:** Po, pas një konsultimi me Komisionerin, më lejoni t’ju përcjell vullnetin e tij për të bashkëpropozuar me Nënkomisioneren projektaktin, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Atëherë unë po kaloj në votimin në parim, ndjesë nëse e kishim kaluar këtë moment, në mos gaboj, jo, nuk është votuar në parim projektvendimi.

**Kush është dakord, kolegë, ju lutem?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka


Me 5 vota pro, miratohet!

Atëherë, unë do ta lexoj tashmë për të përfshirë edhe këtë që sapo na konfirmoi Komisioneri dhe Nënkomisioneria. Në mbështetje të dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 20, pika 1, shkronja “ë” dhe nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi... Jemi dakord me preambulën, apo do të shtojmë dhe nenin 14?

**Z. M. Çakaj:** Shto dhe nenin 14 me bazën ligjore!

**Znj. I. Nano:** Atëherë neni 14, pika 2 duhet të shtohet tek baza ligjore. Kalojmë atëherë tek diskutimi për çdo pikë të nenit. Pika e parë është përdorimi. Pra, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit PEI, që janë përdorur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, në të gjitha qendrat e votimit, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Po, zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**Z. M. Çakaj:** Më fal, një diskutim të vogël! E kam më shumë për saktësi me administratën. Pra, është e nevojshme ta cilësojmë, “nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit që janë përdorur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Në dijeninë time, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka prokuruar këto dhe i ka në pronësi, kështu që për sa kohë i ka në pronësi, nuk është...

**Znj. I. Nano:** Po zonja Koja!

**Znj. M. Koja:** Në fakt ky specifikimi ka pasur si qëllim të respektohet pikërisht vendimi i Komisionit Rregullator mbi standardet që do të plotësojnë pajisjet e identifikimit. Tashmë dimë që ato pajisje që janë përdorur në datën 25 prill, janë ato të prokuruar sipas standarteve që ka përcaktuar vetë Komisioni Rregullator. Ky ka qenë synimi se përse, ndërkohë vetë Kodi Zgjedhor kërkon që këto pajisje, të cilat prokurohen sipas standarteve të përcaktuara, duhet të jenë të tilla që të përdoren së paku pesë zgjedhje radhazi. Pra, qëllimi ka qenë që të qëndrojmë strikt standartit.

**Z. M. Çakaj:** Pra, një standarti, dy të fillojë numërimi pesë zgjedhje radhazi. Pra 1 është standarti i miratuar me vendim, me akt normativ dhe 2, mesa e kuptoj unë, të fillojë numërimi, pesë zgjedhje radhazi?

**Znj. M. Koja:** Kodi thotë, së paku është, kufi minimal! Por kryesisht qëllimi është që këto të jenë pajisje, të cilat janë prokuruar sipas standartit të përcaktuar nga vendimi.

**Znj. I. Nano:** Janë miratuar me vendimin nr. 2 të Komisionit Rregullator!

**Znj. M. Koja:** Pikërisht ky ka qenë qëllimi, të garantojmë standartin, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj, nëse jeni i qartë me këtë sqarim, kalojmë në votimin e pikës 1 të projektvendimit.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju lutem dakordësinë tuaj për këtë pikë.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet!


Kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit "Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022".

**Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU





Me 5 vota pro miratohet!

Duke qenë që nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të diskutuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 10**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

